

# STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “CHINT ALBANIA ELECTRIC” SHPK

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

## Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

### Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 21.11.2022, (njëzenjë Nëntor 2022), unë, themeluesi **Elton Ostreni**, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin CHINT ALBANIA ELECTRIC SH.P.K.
2. Themeluesi i shoqërisë është:

**Elton Ostreni**, lindur në Tiranë, më 20.06.1975, banues në Tiranë, Njësia Administrative nr. 9, rruga Prokop Myzeqari, ndërtesa 12, hyrja 6, apartamenti 40, kodi postar 1016.

### Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

1. Import, eksport, shitje, blerje i paisjeve elektrike te tensionit te mesem dhe te ulet.
2. Projektim, montim, mirembajtje, riparimi i kabinave elektrike, shitje-blerje,
3. Import eksport i mallrave dhe materialeve të ndryshme, pjesë ndërrimi të ndryshme, makineri e pajisje.
4. Montime rrufepritesh, panele elektrike, instalime elektrike dhe kabinaelektrike investime ne fushen e ndertimit, infrastrukturë, sherbime dhe teknologji.
5. Marrje, dhenie me qera apoperdorim i pasurive te paluajshme.
6. Konsulence, supervizion, projektim, mirembajtje dhe realizim i impianteve taprodhimit te energjise elektrike.
7. Shoqeria ka te drejte teushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikaur nga ligji neperputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.
8. Shoqeria ushtron aktivitetin e saj edhe ne baze te autorizimeve dhe/oselejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente tefushes.

### Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të papërcaktuar; Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### Neni 4: Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njësia Administrative Kashar, Mall of Tirana, Kapanoni Nr. 60, Kashar, Tiranë.
2. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: shano.vani@gmail.com.
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon shano.vani@gmail.com.



## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqint mijë) lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Elton Ostreni Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimidhevzogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisëmund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar pë rkontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak pér të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen pér ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, pér sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


## **KREU III**

### **ORGANETVENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 OrganVendimmarrës**

Asambleja e Ortakëveështëorgani i vetem vendimmarrës i shoqërise.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.



Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve për shoqerinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori ishoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9** **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10** **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo njete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**



Asambleja e përgjithshme vendlod me tri tëkatërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendlod me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhenë procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12 Përjashtinga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. **Administrator i shoqërisë CHINT ALBANIA ELECTRIC SH.P.K** emërohet:  
**Vangjush Shano**, lindur në Tiranë, më 01.07.1985, banues në Tiranë, rruga Petro Nini Luarasi, pallati 11, apartamenti 15.
4. Administrator i Shoqërisë “CHINT ALBANIA ELECTRIC” shpk, emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Krijon një system paralajmërimi në kohën e duhur për irrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) Raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, nérastet kur:

- -sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- -shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- -shoqëria, brenda 2 vitevetë para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

- A. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Administratori detyrohet:
  1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënjedis;
  2. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm pë rarritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  3. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  4. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  5. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- B. Administratori gjatë kryerjes së detyrateve të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirë besim.
- C. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave A e B të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim

personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të pa rregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

D. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finanziar-ekspertet**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrëqë të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.


#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit;



- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- e. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19 Riorganizmi i shoqërisë, bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14.04.2012, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare."

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

*ORTAKU I VETËM  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
CHINT ALBANIA ELECTRIC SHPK*

**ELTON OSTRENI**

Tiranë, më: 21/11/2022.

**Vangjush  
Shano**

Digitally signed by  
Vangjush Shano  
Date: 2022.11.21 16:05:20  
+02'00'